



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 019:282625
Datë: 15.02.2021
Numri i dokumentit: 00690476

C.nr. 1394/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm-Gjyqtari Besnik Shala, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit U.B nga fsh. Q. K e P, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av O.L nga P, kundër të paditurve R.B dhe S.B të dy nga fsh. Q K e P, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. S.B nga P, me bazë juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1,000 euro, në seancën e datës 12.03.2021 mori këtë dhe me datë 15.03.2021 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. Konstatohet e tërhequr** padia e paditësit U.B nga fsh. Q, K e P, kundër të paditurve R.B dhe S. B të dy nga fsh. Q K e P, me bazë juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1,000 euro.
- II. OBLIGOHET** e paditësi U.B nga fsh. Q K e P, që të paditurve R. B dhe S.B të dy nga fsh. Q K e P, ti kompensoj shpenzimet procedurale në shumë prej 239 Euro, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me datë 12.11.2019 , kundër të paditurve me bazë juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1.000 euro.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 09.03.2021, ka tërhequr padinë. Duke pasur parasysh nenin 261 par. 1 të LPK-së “Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi” dhe nenin 261 par. 2 të LPK-së “Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë” dhe pasi që në këtë procedurë të paditurit kanë parashtruar përgjigje në padi dhe gjykata ka caktuar seancën e cila është mbajtur me datë 12.03.2021, në ora 9:00, ku në këtë seancë i autorizuari i të paditurve ka dhënë pëlqimin për

tërheqjen e padisë gjithashtu i njëjti ka kërkuar shpenzimet e procedurës për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 456 e lidhur me nenin 463 të LPK-së dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, duke marrë parasysh faktin se paditësi e ka tërhequr padinë dhe i autorizuari i të paditurve i ka kërkuar shpenzimet dhe i ka specifikuar dhe atë (përgjigje në padi shumen prej 104 euro, dhe dy seanca nga 50% të seancave shume prej 135).

Andaj nga të cekurat më lart e duke u bazuar në nenin 261 par. 1, 2, 456, dhe 463 e lidhur me nenin 387 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm,
C.nr.1394/19, data 15.03.2021**

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendim është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate,